URDHËR
Nr. 481, datë 4.5.2026

PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJES SË MURTAJËS SË RUMINANTËVE TË VEGJËL

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, të shkronjës "b", të pikës 1 dhe të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e tregtimit të ruminatëve të vegjël në tregjet e kafshëve të gjalla, panaire dhe grumbullime të tjera në qarkun Elbasan.
2. Ndalimi i lëvizjes së ruminantëve të vegjël dhe specieve të tjera të mbarështuara nga ferma në fermë në zonën e mbrojtur dhe zonën e mbikëqyrjes.
3. Intensifikimin e mbikëqyrjes së popullatave të ruminantëve të vegjël dhe inventarizimin e tyre në zonën e mbrojtur dhe zonën e mbikëqyrjes.
4. Forcimin e masave të biosigurisë.
5. Kafshët e llojit të imëta duhet të mbarështohen sipas kërkesave shëndetësore të mbarështimit të tyre, si dhe të jenë të izoluara nga kafshët e tjera në fermë dhe të kufizohet kontakti me kafshët e tjera.
6. Intensifikimin e fushatave të ndërgjegjësimit të fermerëve, transportuesve të kafshëve, veterinerëve privat dhe shërbimit veterinar shtetëror.
7. Intensifikimin e mbikëqyrjes dhe kontrollit veterinar në fermat që mbarështojnë ruminantë të vegjël dhe tregjet e kafshëve të gjalla në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
8. Zbatimin e masave të tjera të përmendura në urdhrin nr. 802, datë 9.10.2024, "Për miratimin e Planit Kombëtar të Kontigjencës për sëmundjen e Murtajës së Ruminantëve të Vegjël (PPR)".
9. Masat e sipërcituara nga pika 2 deri në pikën 6 zbatohen në territorin e:

Nr.	Njësia Administrative	Fshati
	3 km	
1.	Gjoçaj	Bregas
2.	Gjoçaj	Kurtaj
3.	Gjoçaj	Hasmashaj
4.	Sinaballaj	Sinaballaj
5.	Dushk	Zhamë Fshat
6.	Dushk	Zhamë Sektor
7.	Dushk	Tharasaj
8.	Dushk	Gramsh
9.	Gjoçaj	Bregas
	10 km	
1.	Dushk	Konjat
2.	Dushk	Dushk i Madh
3.	Dushk	Dushk Peqin
4.	Golem	Shegas
5.	Golem	Golem i Vogël
6.	Golem	Golem
7.	Golem	Allprenaj

8.	Gjocaj	Gjocaj
9.	Gjoçaj	Selimaj
10.	Gjoçaj	Blinas
11.	Gjoçaj	Bardhas
12.	Gjoçaj	Rrumbullak
13.	Ballagat	Jazexhiaj
14.	Ballagat	Gjyzaj
15.	Ballagat	Garunjas
16.	Ballagat	Manasufaj
17.	Ballagat	Ballagat
18.	Peqin	Peqin
19.	Përparim	Fatish
20.	Karinë	Karinë
21.	Karinë	Drangaj
22.	Karinë	Progër
23.	Karinë	Kazije
24.	Përparim	Gjevur
25.	Përparim	Çopanaj
26.	Përparim	Kodras
27.	Përparim	Çaushaj
28.	Përparim	Katesh
29.	Rrogozhinë	Rrogozhinë
30.	Sinaballaj	Hasdushk
31.	Sinaballaj	Kodrasej
32.	Tërbuf	Çermë e Sipërme
33.	Tërbuf	Çermë Proshk
34.	Tërbuf	Tërbuf
35.	Gosë	Gosë e Vogël
36.	Gosë	Gosë e Madhe
37.	Gosë	Kërcukaj
38.	Lekaj	Lekaj
39.	Lekaj	Okshtun
40.	Sinaballaj	Thartor

10. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar të Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla